



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOŠOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK
 Nr. Prot. BI Prot. 03-03/1629/20
 Prot. No. 03-03/1629/20
 Nr. ifaq. 03
 Date Datum 10.08.2020
 Nr. ifaq. 03
 Nr. ifaq. 03

| | |
|------------------------|---|
| DATË/A: | 07.08.2020 |
| REFERENC-Ë: | AKK- DPKPP /03-03-1612/20 |
| PËR/ZA/TO: | znj. Zelfije KERMENDI, Menaxher i zyrë së Prokurimit Spitali i Përgjithshëm Pejë |
| CC: | z. Skender DRESHAJ, Drejtor Ekzekutiv Spitali i Përgjithshëm Pejë |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | z. Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit |
| NGA/OD/FROM: | Afrim ATASHI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me Tenderin me titull: "Furnizimi dhe montimi i ashensorëve" |

E nderuara znj. Kelmendii,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **"Furnizim dhe montimi i ashensorëve"** me numër të prokurimit:70030/20/3997/121, dhe me nr. të brendshëm: 70030/20/033/121, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin: **"Furnizimi dhe montimi i ashensorëve"** me numër të prokurimit:70030/20/3997/121, dhe me nr. të brendshëm: 70030/20/033/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 07 gusht 2020, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: **AKK-DPK-03-03/1612 /20**, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: **"Furnizim dhe montimi i ashensorëve"** me numër të prokurimit:70030/20/3997/121, dhe me nr. të brendshëm: 70030/20/033/121, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Spitali i Përgjithshëm Pejë.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike, të llojit furnizim, me vlerë të mesme të parashikuar prej 48,000.00 €.

Në kuadër të rubrikës III.2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional kërkesa 1, Agjencia vëren se, Autoriteti kontraktues **ka kërkuar nga operatorët ekonomik pjesëmarrës të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar minimum 2 (dy) kontrata me sukses për furnizime të ngjashme, gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit në vlerë prej jo me pak se 60,000.00€** Kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndesh me nenin 69 të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik.

Sipas Legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 2.1 parashihet se "Për të vërtetuar aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, autoriteti kontraktues mundet të kërkojë listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë.

Agjencia konsideron se autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të bëjë kufizimin e numrit të kontratave në vlerën e caktuar. E rëndësishme për autoritetin kontraktues është që ta vërtetoj se operatorët ekonomik përmbushin vlerën minimale e cila është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktues pavarësisht numrit të kontratave. E jo si në rastin konkret ku është kërkuar numri i kontratave në vlerë të caktuar.

Konsiderojmë se kërkesat e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomik të cilët kanë një kapacitet të kënaqshëm ekonomik, teknik-profesional.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim dhe Jo-diskriminimi, si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

